

Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë akademik i UK-së, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.

Senati kryesohet nga rektori dhe mblidhet periodikisht.

Anëtarët e Senatit Akademik të UK-së zgjidhen nga asamblatë e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar. Anëtarët e Senatit Akademik të UK-së i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë edhe në “Lektor” me gradën shkencore “Doktor”.

Në Senatin Akademik të UK-së bëjnë pjesë dhe studentë në masën dhjetë përqind të numrit të anëtarëve të Senatit.

Senati Akademik i UK-së përbëhet nga 19 anëtarë, të ndarë sipas skemës në vijim:

-Rektori i zgjedhur, i cili drejton Senatin Akademik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”;

-Të gjithë fakultetet e UK-së janë të përfaqësuar në Senat nga dekani i zgjedhur dhe nga 3 përfaqësues të personelit mësimor-shkencor të secilit fakultet.

-Dy përfaqësues të studentëve, të zgjedhur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”.